



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:010946

Datë: 04.11.2024

Numri i dokumentit: 06394758

C.nr.957/24

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Blerina KURTAJ me bashkëpunëtoren profesionale Gresa Haxhiavdyli, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve 1. K. S., 2. N. B. nga fshati . . .Komuna e Rahovecit, 3. H. K. nga fshati . . . Komuna e Rahovecit 4. F. H. nga fshati . . . Komuna e Rahovecit 5. M. D. XH. nga Prizreni dhe 6. H.K. nga fshati . . . Komuna e Rahovecit të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Agim Metbala avokat në Rahovec Rr. “Dëshmorët e Pashtrikut” - Rahovec, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 8,855.45 euro, jashtë seancës, më 04 Nëntor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësve 1. K. S., 2.N. B. nga fshati . . .Komuna e Rahovecit, 3.H. K. nga fshati Zatriq Komuna e Rahovecit 4.F. H. nga fshati Ratkoc Komuna e Rahovecit 5. M. D. XH. nga Prizreni dhe 6.H.K. nga fshati Zatriq Komuna e Rahovecit dhe DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve të lartcekur të iu paguaj:

- Paditëses K. S. në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 25 muaj të licencimit për pjesën e mbetur, dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 31.01.2023, t’ia paguajë shumën prej 1,483.75 euro;

- Paditësit N. B. në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 25 muaj të licencimit për pjesën e

mbetur, dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 31.01.2023, t'ia paguajë shumën prej 1,483.75 euro;

- Padiësit H. K. në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 25 muaj të licencimit për pjesën e mbetur, dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 31.01.2023, t'ia paguajë shumën prej 1,483.75 euro;

- Padiësës F. H. në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 10 muaj të licencimit për pjesën e mbetur, dhe atë për periudhën kohore nga data 07.04.2022 deri me datë 31.01.2023, t'ia paguajë shumën prej 1,136.70 euro;

- Padiësës M. D. XH. në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 25 muaj të licencimit për pjesën e mbetur, dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 31.01.2023, t'ia paguajë shumën prej 1,483.75 euro;

- Padiësës H.K. në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 25 muaj të licencimit për pjesën e mbetur, dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 31.01.2023, t'ia paguajë shumën prej 1,483.75 euro;

të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 05.01.2024 (datë e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, padiësve t'iu paguaj shumën prej 254.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, në këtë gjykatë me datë 05.01.2024, kanë parashtruar padi kundër të paditurës, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se paditësit janë të punësuar tek e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, si mësimdhënëse. Andaj, kanë kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që t’ia paguaj paditësve në bazë të kualifikimit për periudhën nga data 01.01.2021 e deri me datën 31.01.2023, shumën e përgjithshme prej 8,855.45 euro, për të gjithë paditësit. Kanë kërkuar kamatën ligjore, si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, me datën 23.05.2024, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi, ku ka theksuar se ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar me arsyetimin se paditësve nuk i takon ky kompensim sepse nuk është përcaktuar me kontratën e punës të cilën kontratë e kanë nënshkruar paditësit dhe janë pajtuar me kushtet, detyrat dhe obligimet që i ka. Të paditurës Komuna e Rahovecit i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë (e vetme) në këtë çështje kontestimore, ngase sipas Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 Qeverisë së Republikës së Kosovës, neni 8 është përcaktuar se: për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Ekonomisë dhe financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike”. Ne asnjë pike të vendimit të përshkruar, nuk është obliguar Komuna e Rahovecit që të zbatoj këtë vendim. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i cili ka hyre në fuqi një muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me 01.05.2023, është shfuqizuar Vendimi nr.01/33 i datës 29.08.2008, ndërsa punëtorët e sektorit publik kanë pranuar pagat e muajit shkurt 2023 sipas këtij ligji. Padija e paditësve nuk është bazuar në asnjë bazë të vlefshme juridike, rrjedhimisht nga provat e paraqitura dhe pretendimet e parashtruara me padi, paditësit nuk kanë arritur të argumentojnë themelësinë e kërkesëpadiës ndaj të paditurës, andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënie të aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësës është në tërësi e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditësen, K. S. të lëshuara nga Komuna e Rahovecit–

Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” në fshatin Zatriq, Komuna e Rahovecit si mësimdhënëse. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhat: 01.04.2021-30.04.2021, vërtetohet fakti se paditësja ka realizuar pagë bazë në lartësi prej 421.00 euro dhe në emër të licencës për periudhën kontestuese i është paguar shuma prej 58.32 euro, në emër të kualifikimit. E njëjta ka marrë titullin Bachelor i Programit Fillor me datën 11.12.2015, fakt që vërtetohet përmes diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prizrenit, në Prizren, me numër 122. Po ashtu paditësja ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës me numër 1027414. Nga Kontratat e punës për paditësin, N. B. të lëshuara nga Komuna e Rahovecit–Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” në fshatin Zatriq, Komuna e Rahovecit si mësimdhënëse. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhat: 01.04.2021-30.04.2021, vërtetohet fakti se paditësi ka realizuar pagë bazë në lartësi prej 421.00 euro dhe në emër të licencës për periudhën kontestuese i është paguar shuma prej 58.32 euro, në emër të kualifikimit. I njëjti ka marrë titullin Bachelor i Programit Fillor me datën 29.09.2017, fakt që vërtetohet përmes diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, me numër 1548. Po ashtu paditësi ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës me numër 1027403. Nga Kontratat e punës për paditësin, H. K. të lëshuara nga Komuna e Rahovecit–Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” në fshatin Zatriq, Komuna e Rahovecit si mësimdhënëse. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhat: 01.04.2021-30.04.2021, vërtetohet fakti se paditësi ka realizuar pagë bazë në lartësi prej 421.00 euro dhe në emër të licencës për periudhën kontestuese i është paguar shuma prej 58.32 euro, në emër të kualifikimit. I njëjti ka marrë titullin Bachelor i Biologji-Kimi me datën 22.02.2014, fakt që vërtetohet përmes diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, me numër 331. Po ashtu paditësi ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës me numër 100007625. Nga Kontratat e punës për paditësen, F. H. të lëshuara nga Komuna e Rahovecit–Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” në fshatin Zatriq, Komuna e Rahovecit si mësimdhënëse. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhat: 01.09.2023-30.09.2023, vërtetohet fakti se paditësja ka realizuar pagë bazë në lartësi prej 421.00 euro dhe në emër të licencës për periudhën kontestuese nuk i është paguar diferenca në pagë në emër të kualifikimit. E njëjta ka marrë titullin Bachelor i Programit Fillor me datën 29.11.2019, fakt që vërtetohet përmes diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prizrenit, në Prizren,

me numër 1472. Nga Kontratat e punës për paditësen, M. D. XH. të lëshuara nga Komuna e Rahovecit–Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” në fshatin Zatriq, Komuna e Rahovecit si mësimdhënëse. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhat: 01.04.2021-30.04.2021, vërtetohet fakti se paditësja ka realizuar pagë bazë në lartësi prej 421.00 euro dhe në emër të licencës për periudhën kontestuese i është paguar shuma prej 58.32 euro, në emër të kualifikimit. E njëjta ka marrë titullin Master në Mësimdhënie në Shkencat Natyrore (Fizik-Kimi) me datën 08.05.2019, fakt që vërtetohet përmes diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, në Prishtinë, me numër 555. Po ashtu paditësja ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës me numër 100007936. Nga Kontratat e punës për paditësen, H.K. të lëshuara nga Komuna e Rahovecit–Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” në fshatin Zatriq, Komuna e Rahovecit si mësimdhënëse. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhat: 01.04.2021-30.04.2021, vërtetohet fakti se paditësja ka realizuar pagë bazë në lartësi prej 421.00 euro dhe në emër të licencës për periudhën kontestuese i është paguar shuma prej 58.32 euro, në emër të kualifikimit. E njëjta ka marrë titullin Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe me datën 30.11.1996, fakt që vërtetohet përmes diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, në Prishtinë, me numër 428. Po ashtu paditësja ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës me numër 100007687. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, vendim i cili ka qenë në fuqi deri me datë 06.02.2023, ku është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik numër 08/L-196. Sipas këtij vendimi, në pikën 1 është përcaktuar se *“Që nga data 01.09.2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*, ndërsa pika 4 nën-pika 3 e tij, ka përcaktuar se *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%”*. Pasi

që nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, se e të njëjtit kanë diplomë universitare me titull Bachelor dhe po ashtu kanë licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës, rezulton se konform vendimit të lartcekur, paditësve iu takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, më konkretisht të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare për çdo muaj ashtu që:

1. Paditëses K. S. me kualifikim fakultet (Bachelor) i kompensohet 27% e pagës bazë prej 421.00 euro, përkatësisht për çdo muaj duke i zbritur shumën prej 54.32 euro e cila i është kompensuar sipas listës së pagave dhe të ia paguaj diferencën në pagë në bazë të kualifikimit arsimor shumën prej 59.35 euro, për periudhën prej datës 01.01.2021 e deri me datë 31.01.2023 përkatësisht për 25 muaj të licencimit të ia kompensoj vlerën e përgjithshme në lartësi prej 1,483.75 euro.

2. Paditësit N. B. me kualifikim fakultet (Bachelor) i kompensohet 27% e pagës bazë prej 421.00 euro, përkatësisht për çdo muaj duke i zbritur shumën prej 54.32 euro e cila i është kompensuar sipas listës së pagave dhe të ia paguaj diferencën në pagë në bazë të kualifikimit arsimor shumën prej 59.35 euro, për periudhën prej datës 01.01.2021 e deri me datë 31.01.2023 përkatësisht për 25 muaj të licencimit të ia kompensoj vlerën e përgjithshme në lartësi prej 1,483.75 euro.

3. Paditësit H. K. me kualifikim fakultet (Bachelor) i kompensohet 27% e pagës bazë prej 421.00 euro, përkatësisht për çdo muaj duke i zbritur shumën prej 54.32 euro e cila i është kompensuar sipas listës së pagave dhe të ia paguaj diferencën në pagë në bazë të kualifikimit arsimor shumën prej 59.35 euro, për periudhën prej datës 01.01.2021 e deri me datë 31.01.2023 përkatësisht për 25 muaj të licencimit të ia kompensoj vlerën e përgjithshme në lartësi prej 1,483.75 euro.

4. Paditëses F. H. me kualifikim fakultet (Bachelor) i kompensohet 27% e pagës bazë prej 421.00 euro, të ia paguaj diferencën në pagë në bazë të kualifikimit arsimor shumën prej 113.67 euro, për periudhën prej datës 07.04.2022 e deri me datë 31.01.2023 përkatësisht për 10 muaj të licencimit të ia kompensoj vlerën e përgjithshme në lartësi prej 1,136.70 euro.

5. Paditëses M. D. XH. me kualifikim fakultet (Bachelor) i kompensohet 27% e pagës bazë prej 421.00 euro, përkatësisht për çdo muaj duke i zbritur shumën prej 54.32 euro e cila i është kompensuar sipas listës së pagave dhe të ia paguaj diferencën në pagë në bazë të kualifikimit arsimor shumën prej 59.35 euro, për periudhën prej datës 01.01.2021 e deri me datë 31.01.2023

përkatësisht për 25 muaj të licencimit të ia kompensoj vlerën e përgjithshme në lartësi prej 1,483.75 euro.

6. Paditëses H.K. me kualifikim fakultet (Bachelor) i kompensohet 27% e pagës bazë prej 421.00 euro, përkatësisht për çdo muaj duke i zbritur shumën prej 54.32 euro e cila i është kompensuar sipas listës së pagave dhe të ia paguaj diferencën në pagë në bazë të kualifikimit arsimor shumë prej 59.35 euro, për periudhën prej datës 01.01.2021 e deri me datë 31.01.2023 përkatësisht për 25 muaj të licencimit të ia kompensoj vlerën e përgjithshme në lartësi prej 1,483.75 euro.

Duke qenë se kjo gjendje faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, pasi që e paditura në asnjë formë nuk e ka kontestuar faktin se paditësit janë të punësuar tek e paditura dhe se të njëjtit nga data 01.01.2021 deri me datë 31.01.2023 apo për 25 muaj ju janë kompensuar shuma prej 54.32 euro për çdo muaj, mirëpo nuk i është kompensuar pjesa tjetër e shtesave në emër të kualifikimit shumë prej 59.35 euro për çdo muaj, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Kontrata Kolektive e Arsimit është shkëputur nga data 31.01.2023, andaj paditësve nuk ju takon kompensimi për periudhën pas kësaj date, mirëpo këtë pretendim gjykata e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, i cili ka qenë në fuqi deri me datën 06.02.2023.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 par.1 të LPK-së, me ç'rast paditësve iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 254.00 euro. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00 euro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 234.00 euro, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.957/24, më 04 Nëntor 2024

Gj y q t a r j a

Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.